


Tregtia e jashtme e mallrave

Shkurt 2020

Tiranë, më 17 Mars 2020: Në Shkurt 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 24 mld lekë, duke u rritur me 7,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 5,7 %, në krahasim me Janar 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 52 mld lekë, duke u rritur me 3,5 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 23,1 %, në krahasim me Janar 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 27 mld lekë, duke u rritur me 0,2 %, krahasuar me Shkurt 2019 dhe me 44,4 %, në krahasim me Janar 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në dymujorin e parë të vitit 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, eksportet e mallrave arritën vlerën 47 mld lekë, duke u rritur me 6,5 %, dhe importet e mallrave arritën vlerën 94 mld lekë duke u rritur me 1,7 %. Deficiti tregtar arriti vlerën 46 mld lekë duke u ulur me 2,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 7,5 %, në muajin Shkurt2020 është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +4,0 pikë përqindje, “Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi” me +2,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar negativisht grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,9 pikë përqindje dhe “Ushqim, pije, duhan” me -0,1 pikë përqindje.

Për publikim 17/03/2020

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2020




Eksportet gjatë këtij dymujori janë rritur me 6,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,4 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Tekstile dhe këpucë” me -0,6 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 3,5 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,7 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,5 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,0 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -0,2 pikë përqindje dhe “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,01 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2020



Në dymujorin e parë të vitit 2020 importet janë rritur me 1,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,9 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +0,7 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,5 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,3 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,2 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -0,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shkurt 2020 vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2019 janë: Italia (5,3 %), Spanja (25,6 %) dhe Gjermania (11,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kosova (-15,5 %), Rumania (6,5 %) dhe SHBA (15,2 %).

Gjatë këtij dymujori në krahasim me dymujorin e parë 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve janë: Spanja (46,0 %), Kosova (6,3 %) dhe Gjermania (23,1 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-0,7 %), Franca (25,9 %) dhe Rumania (-20,6 %).

Në muajin Shkurt 2020 në krahasim me Shkurt 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve janë: Turqia (+13,4 %), Greqia (13,7 %) dhe Kina (9,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-1,0 %), Cekia (-13,0 %) dhe Serbia (-7,1 %).

Gjatë këtij dymujori në krahasim me dymujorin e parë 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve janë: Turqia (17,2 %), Greqia (16,7 %) dhe Gjermania (10,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-1,8 %), Kina (-1,4 %) dhe Serbia (-8,5 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt2020



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 64,0 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2020 eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 79,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 56,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,3 %), Greqia (7,2 %), Gjermania (6,7 %) dhe Turqia (6,6 %).

Shkëmbimet tregtare për dymujorin e parë 2020 me vendet e BE zënë 64,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shkurt 2020 eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 80,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 55,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,0 %), Greqia (7,8 %), Gjermania (6,9 %) dhe Turqia (6,8 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	Janar - Shkurt18	47	21,5	91	14,7	-43	52,3
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	Janar - Shkurt19	44	-6,3	92	1,3	-47	48,4
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	24	7,5	52	3,5	-27	47,1
	Janar - Shkurt20	47	6,5	94	1,7	-46	50,6

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Jan.- Shk. 2019	Jan.- Shk. 2020	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Jan.- Shk. 2019	Jan.- Shk. 2020
Vendet e BE-së	18.079	19.293	36.402	38.130	30.137	29.258	53.189	52.300
Austri	153	129	512	295	448	401	855	684
Gjermani	1.185	1.321	2.264	2.787	3.648	3.758	6.272	6.902
Greqi	971	1.111	1.872	2.216	3.848	4.374	7.473	8.721
Itali	11.845	12.469	24.027	23.863	12.901	12.774	23.014	22.608
Spanjë	1.713	2.151	3.180	4.642	657	1.056	1.124	1.771
Kroaci	97	177	145	358	422	354	853	793
Të tjera të BE-së	2.115	1.934	4.401	3.970	8.212	6.543	13.597	10.821
Kinë	194	710	741	1.012	3.840	4.184	8.426	8.305
Kosovë	1.963	1.660	3.052	3.244	539	584	809	1.047
Maqedonia e Veriut	569	596	950	1.090	631	682	1.132	1.285
Mbretëri e Bashkuar	50	49	106	131	423	298	755	741
Rusi	20	-	21	6	930	1.473	1.934	2.831
SHBA	331	281	652	461	767	838	1.593	1.664
Turqi	224	244	509	441	4.209	4.775	7.763	9.097
Ukrainë	20	61	36	66	50	174	476	656
Zvicër	35	71	86	164	2.220	1.930	3.671	2.272
Të tjera	1.126	1.354	1.905	2.586	6.091	7.402	12.178	13.305
Gjithsej	22.611	24.317	44.460	47.329	49.836	51.598	91.926	93.503

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Jan.- Shk. 2019	Jan.- Shk. 2020	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Jan.- Shk. 2019	Jan.- Shk. 2020
Gjithsej	22.611	24.317	44.460	47.329	49.836	51.598	91.926	93.503
Ushqime, pije, duhan	2.260	2.247	4.231	4.327	7.855	8.206	15.297	15.798
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	3.160	4.056	6.505	8.015	7.265	5.785	13.481	10.467
Produkte kimike dhe plastike	475	613	990	1.150	6.757	7.486	12.036	12.530
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	213	262	435	470	1.360	1.356	2.511	2.323
Prodhime druri dhe letre	728	763	1.501	1.539	1.917	2.117	3.362	3.637
Tekstile dhe këpucë	9.977	10.199	20.205	19.951	6.766	6.880	12.719	12.649
Materiale ndërtimi dhe metale	3.645	3.434	6.454	6.709	5.709	7.576	10.291	12.957
Makinëri, pajisje dhe pj. këmb.	1.417	1.951	2.820	3.660	10.521	10.400	19.129	19.774
Të tjera	736	792	1.319	1.508	1.686	1.791	3.099	3.367

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Spanjë		Kosovë		Gjermani	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	24.027	23.863	3.180	4.642	3.052	3.244	2.264	2.787
Ushqim. pije duhan	1.297	1.390	226	152	360	397	223	262
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	661	250	2.556	4.078	876	336	244	182
Produkte kimike dhe plastike	319	369	3	44	215	287	11	6
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	367	373	22	44	1	2	3	2
Prodhime druri dhe letre	1.095	1.064	1	1	114	105	23	32
Tekstile dhe këpucë	15.830	15.271	352	270	9	14	1.158	1.625
Materiale ndërtimi dhe metale	2.318	2.286	18	38	1.175	1.175	250	197
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	1.503	2.187	2	5	80	164	245	354
Të tjera	637	673	1	10	222	266	107	126

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Turqi		Greqi		Kinë	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	23.014	22.608	7.763	9.097	7.473	8.721	8.426	8.305
Ushqim. pije duhan	2.636	2.795	782	858	2.052	2.433	187	112
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	1.105	501	80	287	1.697	2.014	0	3
Produkte kimike dhe plastike	2.479	2.541	1.090	1.052	975	1.214	876	864
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.094	1.926	38	44	5	6	95	102
Prodhime druri dhe letre	941	1.028	438	452	433	519	108	167
Tekstile dhe këpucë	6.105	5.676	2.499	2.664	562	677	1.519	1.596
Materiale ndërtimi dhe metale	2.488	2.864	1.753	2.116	1.164	1.317	1.193	1.296
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	4.447	4.524	840	1.409	363	334	3.824	3.360
Të tjera	719	753	242	215	223	207	624	807

Meodologji

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë. Gjermani. Francë. Itali. Luksemburg. Holandë. Mbretëria e Bashkuar. Danimarkë. Irlandë. Greqi. Spanjë. Portugali. Austri. Finlandë. Suedi. Qipro. Çeki. Estoni. Hungari. Letoni. Lituani. Maltë. Poloni. Slovaki. Slloveni. Bullgari. Rumani. Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri